



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/167

Datë: 13.03.2019

Procesverbal

i mbledhjes se II ( e dytë ) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/117 datë:05.02.2019 dhe marrja e vendimit në lidhje me kërkesën nr.01/78 datë:24.01.2019 e parashtruar nga kryetari i fshatit Terpezë e Poshtme , për ndërtimin e Xhamisë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2019.
4. Shqyrtimi i përgjigjes së Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso- Juridik nr.02/541 datë: 19.12.2018 lidhur me kërkesën nr.02/507 datë:04.12.2018, për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për z. Arsim Kransiqi.
5. Shqyrtimi i raportit të KRU “Hidroregjioni Jugor”, njësia operative në Malishevë.
6. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Diasporë për vitin 2018.
7. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2018
8. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2018
9. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2018.
10. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2018
11. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës për vitin 2018.
12. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2018.
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2018.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës nr.01/138 datë:08.02.2019 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
15. Inicimi i procedurave për plotësimim dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
16. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/19.
17. Shqyrtimi i kërkesave.
18. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë 20.02.2019, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e dytë, rendin e ditës e keni hapi debat.

Kush jeni për këtë rend të ditës? Për rendin e ditës ishin 4 anëtarët e KPF-së.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Hashim Vrenezi: Në procesverbal është mirë të shkruhen ato çka i themi, sepse në mbledhjen e kaluar kam folur më shumë në lidhje atë pikën për Astrazup që e kemi pas.

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të këtij procesverbalit me vërejtje? Unanimisht 4 ishin për.

2. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/117 datë:05.02.2019 dhe marrja e vendimit në lidhje me kërkesën nr.01/78 datë:24.01.2019 e parashtruar nga kryetari i fshatit Terpezë e Poshtme , për ndërtimin e Xhamisë.

Alban Krasniqi: Sa i përket kësaj kërkesë duhet me ditë sa është mandati i kryetarëve të fshatrave dhe çfarëdo kërkesë tani që vjen prej tyre duhet të llogariten si kërkesa të qytetarëve se ata kryetar s'kanë më bazë deleguese, duhet mi shpallë zgjedhjet për kryetar të rij të fshatrave. Për kërkesën me qellim të sqarimit në fshatin Carrallukë ai kryetar tani ska më mandat, por edhe sa konsultuar as me kryesinë dhe as me fshatin,

banorët e fshatit Tërpezë janë të indinjuar sepse s'janë konsultuar. Kjo kërkesë ka probleme procedurale, shkresa e BIK, peticioni dhe ska nënshkrime, pastaj thuhet për tri fshatra e këtu ka laramani. Kryetaret s'kanë mandat janë jashtë kompetencës së Komunës, kërkesat duhet të vijnë prej peticionit e pastaj kryetari me kryesi të fshatit fillojnë brenda suazave në kuadër të infrastrukturës publike. Hapësira ku është cekë aty parashihet gjelbërim në atë fshat, vendi duhet të specifikohet prej drejtorive siç janë Urbanizmi dhe Gjeodezia, pastaj duhet me ditë sa është hapësira larg shkollës. Prej BIK-ut duhet me ditë për objekt fetar kah vijnë mjetet-fondet me pas një siguri të madhe, sepse ka pas raste objektet fetare janë keqpërdor për radikalizëm fetar, nuk ka transparencë këtu, kanë marrë vendime për Xhami e nuk shkon askush aty, pastaj pse Xhamitë me kanë me Minare. Nuk jam parimisht kundër Xhamive por t'i respektojnë rregullat, të ketë debat me qytetarë e kjo nënkupton se jemi të indoktrinuar prej këtyre çështje, pra vendi, hapësira, legjitimiteti, fondi, toka, statusi saj, projekti, skadimi i mandatit i këtyre kryetarëve krejt këto janë parakushte me ardh deri të kjo kërkesë.

Rahim Morina: Për mandatin e tyre përgjegjësia bien te Kuvendi, sepse Kuvendi i organizon zgjedhjet për kryetar të fshatrave, ose ka mujt me një vendim me ju zgjat mandatin. Ka pas raste janë ndërtuar Xhami sa dijë unë edhe Emiratet e bashkuara Arabe kanë siguruar fondet, e ne mund të kërkojmë më një shkresë edhe fondet edhe krejt këto çka i ceku Albani, pastaj edhe kryesitë e fshatrave duhet ta nënshkruajnë pëlqimin, pra dokumente plotësuese mund të kërkojmë nga parashtruesit të kësaj kërkesë.

Hashim Vrenezi: Kërkesa është e mangët, ka pas konsultim të ngushtë të dihet prejardhja e mjeteve dhe nëse në atë vend a parapa gjelbërim qysh me ndërtuar, kërkesa është dashtë mu pasqyruar më mirë.

Rahim Morina: Duhet me pas peticion me nënshkrime të kryesive, banorëve të tri fshatrave, vendi ku a parapa, identifikimi i ngastrës, largësia nga shkolla. Kush jeni qe të gjitha këto që u ceken te kërkoheh përmes një shkrese.

Unanimisht ishin për që me shkresë përcjellëse me kërkuar dokumente shtesë.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2019.

Raimonda Krasniqi: Kryesues nëse ka mundësi mbledhjet të mbahen ditëve të Premte, sepse ashtu edhe jemi marrë vesh.

Rahim Morina: Po por ne po kemi problem me përgatitjen e mbledhjeve, sepse drejtoritë po vonohen në sjellje të materialeve.

Hashim Vrenezi: Sa i përket planit të prokurimit ky s'është përfundimtar e ky mundet mu ndryshuar, e qe sipas shënimeve ky është në shperputhje me buxhetin e miratuar nga Kuvendi. Këta kanë bërë një plan të mjegulluar e që ka me pas problem me zbatuar. Në buxhet a kanë paisje në bujqësi me traktor, e këta kanë futë prapë paisje me sera e ndoshta fusin edhe multikultivator. Subvencionimi i ndërmarrjeve publike këtu nuk ceken, ka raste si kanalizimet ne Drenoc tash është hjekë, ndërtimi i trotuareve në Bellanicë ska qenë tash ka hy në ketë plan, nxemja në objektin e ri në Komunë ka hy. Në Gurëbardh i kanë bashkuar disa projekte, po ashtu edhe në Marali. Renovimi i objekteve shkollore 150 mijë se di pse, shkolla e Panorcit nuk është në buxhet, ky plan është dashtë të jetë i detajuar dhe ne përputhje me buxhetin, e qe tani është në shpërputhje te totali. Me informata të theksuara është dashtë të jetë e jo veç me emra të fshatrave por të specifikohen edhe lagjet.

Rahim Morina: Unë kam kontaktuar me Nuhiun jo zyrtarisht me ka thënë se ky plan nuk është përfundimtar e ne në Mars mund të kërkojmë informata shtesë.

Alban Krasniqi: Vërejtja e parë jo nga rëndësia shihet se ne i kemi specifikuar në buxhet edhe lagjet me metra e këtu janë veç emrat e fshatrave e kjo qon në shkelje. Në Carrllukë ka raste qe tri vite tenderohen rrugët qëllimisht, duhet me ju bërë te qartë se nëse prokurimi bënë këto shkelje duhet drejt mi qu në prokurori se injorimi i kuvendit duhet marrë fund se ka projekte që s'janë përfshi, shkolla në Malishevë s'është fut në plan, pra duhet projektet e vitit 2019 mi përfshi.

Hashim Vrenezi: Edhe në ueb faqe të prokurimit të shpalljet duhet mu cek rruga, emri dhe sa metra. Nëse projektet janë në procedurë duhet mu shpalos.

Rahim Morina: Kanalizimet në Drenoc nuk saktësohen, të specifikohen gjitha projektet sipas buxhetit të miratuar. Në me një shkresë i drejtohem prokurimit, të precizohen projektet e Qeverisë së Kosovës për Komunën e Malishevës për vitin 2019, si dhe të specifikohen të gjitha projektet sipas Buxhetit të miratuar për Komunën e Malishevës për vitin 2019.

Kush jeni që këtë pikë ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin 5 anëtarë.

4. Shqyrtimi i përgjigjes së Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoresh Juridik nr.02/541 datë:19.12.2018 lidhur me kërkesën nr.02/507 datë:04.12.2018, për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për z. Arsim Krasniqi.

Rahim Morina: Deri sa ka problem gjyqësor për atë vend aty unë s'jam me rekomanduar për Kuvend, po ashtu as kryetari si ka dhënë leje atij, në vitin 1997 ju kish barte pronësia e tash këtij personit ja ka shitur banka.

Hashim Vrenezi: Nëse e ka shitur banka atë vend aty s'mundet me pas probleme tjera ligjore.

Alban Krasniqi: Njerëzit në atë kohë janë vrrarë nëpër beteja e dikush me Gjykurën në atë kohë ka bërë pazare, ne e dimë edhe rastin tokë për këso lloj problemesh, pra dikush duhet mu marr me këto probleme. Aty ka qenë i ndërtuar stacioni i Policisë dhe ska mund aty me kanë pronësia private, ne tash a më mirë është me pritë apo mi lanë njerëzit me investu e nesër meju prishë duhet mu definua këto.

Rahim Morina: Çuditë në këto raste një Gjykatë ja njeh e një tjetër jo në s'kemi as shtet ligjor e as pushtet, por me këtë çështje ne s'kemi çka të merremi ai letë vazhdon me gjykatë të merret.

5. Shqyrtimi i raportit të KRU "Hidroregjioni Jugor", njësia operative në Malishevë.

Unanimisht ishin 5 anëtar të rekomandohet për Kuvend.

6. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Diasporë për vitin 2018.

7. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2018

8. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2018

9. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2018.

10. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2018

11. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës për vitin 2018.

12. Shqyrtimi i Raportit të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2018.

13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2018.

Raimonda Krasniqi: Mirë është që këto raporte t'i rekomandojmë në pako për kuvend.

Rahim Morina: Materialet i keni pas, nëse s'keni diçka me shtu për raportet kush jeni të rekomandohen? Unanimisht ishin që nga pika 6 deri në pikën 13 për rekomandohen për Kuvend.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës nr.01/138 datë:08.02.2019 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Unanimisht ishin që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend.

15. Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.

Alban Krasniqi: Kuvendi deri në miratim të rregullores së re me marr vendim me shfuqizua çdo vendim sidomos për subvencionet në bujqësi. Tri shpalljet e fundit në Bujqësi disa kanë qenë në afat 10 dite e disa me 7 ditë e kjo ka qenë krejt e sajuar por ata i kanë shkelë procedurat te njoftimet.

Rahim Morina: Kuvendi mund të merr vendim që deri në rregulloren e re mos te ndahen subvencione. Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

16. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/19.

Raimonda Krasniqi: Të futen në raport të DKA-së të gjitha konkurset gjatë muajit shtator-dhjetor 2018, për praninë të punëtorëve, pra listat e atyre që kanë aplikuar dhe të pranuarit në punë.

Rahim Morina: Këto i kërkojmë më një kërkesë drejtuar Dka, për plotësim të raportit. Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë? Unanimisht ishin për.

Alban Krasniqi: Kryesues me kërkoj leje se me duhet me dalë pasi që kam punë ju përshëndes.

17. Shqyrtimi i kërkesave.

-kërkesa nr.02/68 datë: 06.02.2019 e parashtruar nga z. Januz Krasniqi nga fshati Pagarushë

Rahim Morina: Ky është punëtor i Komunës gjendjen shëndetësore se ka të mirë, ka pas ndërhyrje kirurgjike nëse nuk gaboj në zëmër, ka kërkuar me që t'i ndihmojmë.

Valon Krasniqi: Kërkesat kur behën për raste shëndetësore mirë është t'i shqyrtojmë me seriozitet të njëjtë.

Hashim Vrenezi: T'i analizojmë këto kërkesa por e di që trajtimet që nuk kryhen brenda vendit edhe Ministria ka mundësi t'i ndihmoj për trajtim jashtë vendit, e munden me kërkuar edhe prej Qeverisë mbështetje.

Rahim Morina: Kush jeni që Januz Krasniqit t'i ndahen 1000 euro për shërim? Unanimisht ishin për.

-kërkesa nr.02/91 datë: 08.02.2019 e parashtruar nga z. Adem Paqarizi nga fshati Lubizhdë

Rahim Morina: Edhe ky është punëtor i Komunës, por ky e kish një djalë të sëmurë, e ka kërkuar t'i ndihmojmë.

Raimonda Krasniqi: Ka raste që këso kërkesa për shërim i drejtohen edhe kryetarit por presin më nga një vit, sepse di raste që ska marrë asnjë përgjigje.

Rahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen 1000 euro për shërim të djalit të Adem Paqarizit? Unanimisht ishin për.

-kërkesa nr.02/100 datë: 13.02.2019 e parashtruar nga z. Muhamet Krasniqi nga fshati Astrazup.

Rrahim Morina: Edhe Muhameti gjendjen shëndetësore se ka të mire, është veteran i Luftës.

Kush jeni ta ndihmojmë me 550 euro? Unanimisht ishin për.

-Kërkesa e Haxhi Hazrollit nga fshati Banjë për falje të borxhit.

Rrahim Morina: Unë kam kërkuar nga Mapl pasi këtë lëndë e kemi trajtuar edhe në Kuvend, Mapl na ka kthyer një përgjigje gabim pasi që ata e kanë dërguar në një Ministri tjetër, por në s'kemi çka të merremi me këtë kërkesë.

-kërkesa nr.01/188 dat:20.02.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për marrjen e vendimit, sipas kërkesës nr.01/176 datë:14.02.2019 të parashtruar nga kryesia e Lagjes Matoshi-Qytetit të Malishevës, për caktimin e lokacionit për realizmin e projektit të Komunitetit "Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit".

Hashim Vrenezi: Me sa e pash në kërkesë ka gabim te numri i ngastrës.

Rrahim Morina: Ne nëse e rekomandomë për Kuvend këtë kërkesë duhet me cekë edhe kohën e dhënjës në shfrytëzim. Kush jeni për rekomandim për Kuvend këtë kërkesë.

Unanimisht ishin për të rekomandohet.

Hashim Vrenezi: Për kryetar të fshatrave jemi vonuar e duhet t'i shpallim zgjedhjet, sepse ata tash janë pa mandat.

Valon Krasniqi: Kryesues të pyes çka u bë me zyrat për parti.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:30 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

